

Termat e Referencës (ToR)

Ndërmjetës Rinor (Youth Mediator) 1 pozicion

Titulli i projektit	MOBILIZE – Mobile Outreach and Skills Activation for NEET Youth in Remote Communities”
Pozicioni	Ndërmjetës Rinor (Youth Mediator)
Lloji i kontratës	Kontratë pune individuale me kohë të pjesshme (12 muaj)
Zona e zbatimit	Tiranë

Informacion i përgjithshëm mbi organizatën:

FONDACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA (FSHDPAK) është themeluar në Janar të vitit 1994 si degë e OXFAM për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Në tetor të 1996, dega e OXFAM-it për aftësitë e kufizuara u kthye në një OJQ/OJF të pavarur e regjistruar në Shqipëri. FSHDPAK erdhi si një përgjigje ndaj mungesës së mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara dhe legjislacionit të duhur për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Misioni i FSHDPAK është të promovojë mundësi të barabarta dhe përkrahje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut duke çuar në përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara dhe për familjarët tyre.

Filozofia e FSHDPAK bazohet në modelin shoqëror për aftësitë e kufizuara dhe në të gjitha pengesat e targetuara, të krijuara nga shoqëria, të cilat pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore, ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë.

Informacion rreth projektit:

Projekti MOBILIZE – Mobile Outreach and Skills Activation for NEET Youth in Remote Communities zbatohet nga Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA), në partneritet me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK/ADRF), në kuadër të projektit “BE për Rininë”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga PNUD dhe UNICEF në Shqipëri, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë, nën koordinimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Qëllimi i projektit është të zgjerojë aksesin në shërbimet e Garancisë Rinore për të rinjtë NEET (15–29 vjeç) që janë të vështirë për t’u arritur, në komunitetet e largëta dhe të nënperfaqësuar në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër, përmes ekipeve lëvizëse të angazhimit në terren, të cilat ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse dhe të personalizuar para-përgatitore dhe përgatitore.

Qëllimi i shërbimit:

Ndërmjetës Rinor (Youth Mediator) do të jetë pjesë e njësive lëvizëse të projektit dhe do të shërbejë si urë lidhëse midis projektit dhe të rinjve NEET (15–29 vjeç) në komunitet, duke ndërtuar besim dhe duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet dhe shërbimet e projektit dhe në shërbimet e Garancisë Rinore.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Nën mbështetjen dhe supervizimin e ekipit koordinues të programit, Ndërmjetës Rinor (Youth Mediator) do të ketë këto përgjegjësi:

- Angazhon të rinjtë në komunitet përmes qasjes peer-to-peer
- Ndihmon në organizimin e aktiviteteve outreach dhe sesioneve informuese
- Mbështet identifikimin dhe referimin e të rinjve NEET
- Shoqëron përfituesit gjatë procesit të regjistrimit dhe orientimit
- Ofron mbështetje motivuese dhe këshillim bazë
- Ndihmon në ndërtimin e besimit midis komunitetit dhe institucioneve
- Identifikon pengesat sociale dhe familjare dhe i adreson në bashkëpunim me ekipin
- Merr pjesë në mbledhje dhe trajnime të projektit
- Raporton progresin dhe feedback-un nga komuniteti

Përveç këtyre, Ndërmjetës Rinor (Youth Mediator) është përgjegjës për respektimin e standardeve profesionale dhe etike në punën e tij.

Kualifikimet dhe eksperiencia:

- Moshë e preferuar: 20–29 vjeç
- Njohje e mirë e komunitetit lokal
- Eksperiencë në punë me të rinj ose aktivitete komunitare (avantazh)
- Aftësi të mira komunikimi dhe motivimi
- Besueshmëri dhe aftësi për të ndërtuar marrëdhënie
- Njohuri bazë për përdorimin e teknologjisë (telefon, aplikacione)
- Motivim për të punuar me grupe vulnerabël

Procedura e aplikimit:

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është data 20 Maj 2026 dhe duhet të dërgojnë dokumentat si më poshtë:

- një shprehje interesi
- Curriculum Vitae (CV)

Dokumentet të dërgohen në adresën email: info@adrf.al ose fizikisht me zarf dhe vulë pranë zyrave tona në adresën:

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,

Rruga Bogdanëve, Nr. 19. Tiranë

Të rëndësishme:

-Të gjithë personat e përfshirë në programet e FSHDPAK/ADRF, duke përfshirë stafin e brendshëm, stafin e jashtëm, ekspertët, kontraktorët, vullnetarët dhe mbështetësit, janë të detyruar të respektojnë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, masat kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, rregulloret e brendshme të FSHDPAK-së, kodin e sjelljes, si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu, ata duhet të jenë të informuar dhe të zbatojnë çdo dokument tjetër të rëndësishëm në këtë fushë.

-Të gjithë individët që angazhohen në marrëdhënie bashkëpunimi me FSHDPAK nënshkruajnë kontratat përkatëse dhe njihen me politikën e FSHDPAK -s, të cilat përshkruajnë të drejtat dhe përgjegjësitë e secilës palë.